

VENDIM
Nr.239, datë 27.2.2008

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË FINANCIVE,
PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE, TË DISA SIPËRFAQEVE,
TRUALL, TË CILAT JANË NË JURIDIKSION TË KOMUNAVE, NË QARQET TROPOJË,
DIBËR, KORÇË E KUKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave, për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave:

a) të sipërfaqes, truall, prej 7260 m², pronë publike, në juridiksion të komunës Tropojë e vjetër/ Tropojë;

b) të sipërfaqes, truall, prej 3488 m², pronë publike, në juridiksion të komunës Maqellarë /Peshkopi;

c) të sipërfaqes, truall, prej 4350 m², pronë publike, në juridiksion të komunës Buçimas /Pogradec;

ç) të sipërfaqes, truall, prej 6455 m², pronë publike, në juridiksion të komunës Liqenas/Korçë;

d) të sipërfaqes, truall, prej 8750 m², pronë publike, në juridiksion të komunës Golaj/Kukës.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe komunat Tropojë e Vjetër, Maqellarë, Buçimas, Liqenas e Golaj, si dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të qarqeve Tropojë, Dibër, Korçë dhe Kukës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha